**AKT THEMELIMI**
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**
**"ANES" Sh.p.k.**

Sot më datë 08.01.2024, palët e mëposhtme:

- **Z. Artur Asllani**, qytetar shqiptar, lindur më 12.08.1973, në Tiranë, Shqipëri, banues në Rruga "Medar Shtylla", Pall. Tirhino, Kulla D, Ap. 16, Zip Kode 1001, Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit shqiptar me nr. 038730133 dhe numer personal H30812127J;
- **Z. Neritan Kallfa**, qytetar shqiptar, lindur më 23.03.1969, në Tiranë, Shqipëri, banues në Rruga "Ibrahim Shalqizi", Mjull Bathore, Farke Sauk, Rezidenca "Touch of the Sun", Godina B4, Ap. 404, Zip Kode 1044, Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit shqiptar me nr. 033708601 dhe numer personal G90323173Q;
- **Z. Ervin Bano**, qytetar shqiptar, lindur më 21.07.1977, në Vlorë, Shqipëri, banues në Rruga "Ndreke Luca", Ndertesa 10, Hyrja 3 Ap. 17,Zip Kode 1019, Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit shqiptar me nr. 036027418 dhe numer personal H70721130E; dhe
- **Z. Sajmir Dautaj**, qytetar shqiptar, lindur më 25.08.1976, në Tiranë, Shqipëri, banues në Rruga "Sytki Çiço", Pall. 2, Shk. 1, Ap. 1, Zip Kode 1008, Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit shqiptar me nr. 033611182 dhe numer personal H60825117I;

të cilët kanë vendosur të nënshkruajnë Aktin e Themelimit të mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë "**Shoqëria**"), aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij akti, së cilës i bashkëngjitet (më poshtë "Shtojca 1").

**Neni 1 - Emërtimi**

1.1 Emërtimi i Shoqërisë është "ANES" Sh.p.k.

**Neni 2 - Selia**

2.1 Selia e Shoqërisë është në Rruga "Abdi Toptani", Torre Drin, Kati 2, zyra 21/1, Tiranë, Shqipëri.

**Neni 3 - Kohëzgjatja**

3.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë do të jetë për një afat të pacaktuar.

**Neni 4 – Objekti i shoqërisë**

4.1 Shoqëria ka për objekt kryerjen e aktiviteteve tregtare në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

4.2 Në mënyrë më specifike, Shoqëria ka për objekt kryerjen e shërbimeve profesionale të këshillimit në favor çdo individi, personi fizik dhe personi juridik si vijon:

(a) Këshillim dhe asistencë në çështje të administrimit dhe të organizimit, të nevojshme për funksionimin e aktivitetit të klientëve;
(b) Përditësim dhe organizim kontabiliteti, konsulencë kontabiliteti, fiskale, financiare, tatimore si edhe përgatitje pasqyrash financiare;
(c) Asistencë në aplikimin dhe nxjerrjen e lejeve, liçensave, autorizimeve të nevojshme për kryerjen e aktivitetit të klientëve;

(d) Këshillim lidhur me analiza teknike e profesionale për vlerësimin e lejeve, liçensave, autorizimeve, konçesioneve, akteve administrative apo kontratave dhe operacioneve tregtare dhe jo-tregtare që lidhen me klientët;
(e) Këshillim në fushën e organizimit, funksionimit, ndarjes së përgjegjësive të shoqërive tregtare dhe/ose organizatave joftimiprurese;
(f) Këshillim në fushën e punësimit;
(g) Realizimin e studimeve te fizibilitetit dhe të planeve të biznesit;
(h) Veprimtari komisionere, ndërmjetësime, përfaqësime në transaksione tregtare si edhe në secilën prej fushave të objektit të shoqërisë sipas këtij neni;
(i) Asistencë dhe këshillim në operacione që lidhen me krijimin, shndërrimin, transformimin, prishjen, likujdimin apo falimentimin e shoqërive tregtare dhe të organizatave jofitimprurëse;
(j) Këshillim dhe asistencë lidhur me pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, përfshirë edhe asistencë dhe hartim raporte të vlerësimit;
(k) Këshillim dhe asistencë lidhur me çështje mjedisore, përfshirë edhe asistencë dhe hartim raporte të vlerësimit;
(l) Çdo këshillim, asistencë dhe shërbim tjetër që lidhet me administrimin apo çështjet e biznesit e në fusha të ngjashme me to.

4.3 Shoqëria mund të kryejë çdo operacion tregtar, operacione që lidhen me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, operacione financiare dhe kredimarrje, të japë garanci të tretëve si edhe të blejë dhe shesë ose marrë me qira ndërmarrje, degë ndërmarrjesh, si edhe të ketë pjesëmarrje në shoqëri, ente, konsociume, që kanë objekt të njëjtë ose të ngjashëm me të vetin apo gjithsesi funksional për arritjen e qëllimeve të shoqërisë. Më në përgjithësi, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të shoqërisë.

4.4 Me qëllim përmbushjen e secilit prej aktiviteteve që përbëjnë objektin e saj, Shoqëria mund të kontraktojë apo angazhojë çdo person, qoftë individ apo subjekt juridik.

**Neni – Selia**

5.1 Selia e Shoqërisë është në Rruga "Abdi Toptani", Torre Drin, Kati 2, zyra 21/1, Tiranë, Shqipëri.

5.2 Transferimi i selisë së Shoqërisë në një vend tjetër bëhet me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme.

5.3 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë.

**Neni 6 – Kapitali themeltar**

6.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është ALL 100,000 (njëqindmijë Lekë).

6.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 4 (katër) kuota, të gjitha të nënshkruara dhe të shlyera nga ortakët.

**Neni 7 - Kontributet**

7.1 Kontributi në kapitalin e Shoqërisë është ofruar si më poshtë:

- **Z. Artur Asllani**, qytetar shqiptar, lindur më 12.08.1973, në Tiranë, Shqipëri, banues në Rruga "Medar Shtylla", Pall. Tirhino, Kulla D, Ap. 16, Zip Kode 1001, Tiranë, Shqipëri,

mbajtës i letërnjoftimit shqiptar me nr. 038730133 dhe numer personal H30812127J ka ofruar një kontribut në para të barabartë me ALL 25,000 (njëzetepesëmijë Lekë), në favor të shoqërisë në themelim e sipër;

- Z. Neritan Kallfa, qytetar shqiptar, lindur më 23.03.1969, në Tiranë, Shqipëri, banues në Rruga "Ibrahim Shalqizi", Mjull Bathore, Farke Sauk, Rezidenca "Touch of the Sun", Godina B4, Ap. 404, Zip Kode 1044,Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit shqiptar me nr. 033708601 dhe numer personal G90323173Q ka ofruar një kontribut në para të barabartë me ALL 25,000 (njëzetepesëmijë Lekë), në favor të shoqërisë në themelim e sipër;
- **Z. Ervin Bano**, qytetar shqiptar, lindur më 21.07.1977, në Vlorë, Shqipëri, banues në Rruga "Ndreke Luca", Ndertesa 10, Hyrja 3 Ap. 17, Zip Kode 1019,Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit shqiptar me nr. 036027418 dhe numer personal H70721130E ka ofruar një kontribut në para të barabartë me ALL 25,000 (njëzetepesëmijë Lekë), në favor të shoqërisë në themelim e sipër; dhe
- **Z. Sajmir Dautaj**, qytetar shqiptar, lindur më 25.08.1976,, në Tiranë, Shqipëri, banues në Rruga "Sytki Çiço", Pall. 2, Shk. 1, Ap. 1,Zip Kode 1008, Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit shqiptar me nr. 033611182 dhe numer personal H60825117I ka ofruar një kontribut në para të barabartë me ALL 25,000 (njëzetepesëmijë Lekë), në favor të shoqërisë në themelim e sipër.

7.2 Sipas kontributeve të mësipërme:

- **Z. Artur Asllani**, qytetar shqiptar, lindur më 12.08.1973, në Tiranë, Shqipëri, banues në Rruga "Medar Shtylla", Pall. Tirhino, Kulla D, Ap. 16, Zip Kode 1001, Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit shqiptar me nr. 038730133 dhe numer personal H30812127J i përket 1 (një) kuotë, që i korrespondon 25% (njëzetëepesëpërqind) të kapitalit të Shoqërisë;
- **Z. Neritan Kallfa**, qytetar shqiptar, lindur më 23.03.1969, në Tiranë, Shqipëri, banues në Rruga "Ibrahim Shalqizi", Mjull Bathore, Farke Sauk, Rezidenca "Touch of the Sun", Godina B4, Ap. 404, Zip Kode 1044,Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit shqiptar me nr. 033708601 dhe numer personal G90323173Q i përket 1 (një) kuotë, që i korrespondon 25% (njëzetëepesëpërqind) të kapitalit të Shoqërisë;
- **Z. Ervin Bano**, qytetar shqiptar, lindur më 21.07.1977, në Vlorë, Shqipëri, banues në Rruga "Ndreke Luca", Ndertesa 10, Hyrja 3 Ap. 17, Zip Kode 1019, Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit shqiptar me nr. 036027418 dhe numer personal H70721130E i përket 1 (një) kuotë, që i korrespondon 25% (njëzetëepesëpërqind) të kapitalit të Shoqërisë; dhe
- **Z. Sajmir Dautaj**, qytetar shqiptar, lindur më 25.08.1976, në Tiranë, Shqipëri, banues në Rruga "Sytki Çiço", Pall. 2, Shk. 1, Ap. 1, Zip Kode 1008, Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit shqiptar me nr. 033611182 dhe numer personal H60825117I i përket 1 (një) kuotë, që i korrespondon 25% (njëzetëepesëpërqind) të kapitalit të Shoqërisë.

## Neni 8 – Transferimi i kuotave

8.1 Kuotat i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

## Neni 9 – Administrimi

9.1 Me këtë akt emërohet 1 (një) Administrator i Shoqërisë, për një afat 5 (pesë) vjeçar, personi si më poshtë:

- **Z. Neritan Kallfa**, qytetar shqiptar, lindur më 23.03.1969, në Tiranë, Shqipëri, banues në Rruga "Ibrahim Shalqizi", Mjull Bathore, Farke Sauk, Rezidenca "Touch of the Sun", Godina B4, Ap. 404, Zip Kode 1044,Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit shqiptar me nr. 033708601 dhe numer personal G90323173Q.

A NK

9.2 Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 95 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*" dhe nenit 14 të Statutit.

9.3 Administratorit i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer të formalitetet e përmbushjen e detyrimeve të parashikuara për themelimin e regjistrimin e Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim, Administratori, mund t'u drejtohet për ndihmë të tretëve ose konsulentëve të cilëve mund t'u delegojë në tërësi ose pjesërisht kryrjen e aktivitetit të sipërpërmendur.

**Neni 10– Gjuha**

10.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 6 (gjashtë) kopje në gjuhën shqipe.

* * *

ORTAKËT

| | |
|---|---|
| **Z. Artur Asllani** | NERITAN KALLFA<br>**Z. Neritan Kallfa** |
| **Z. Ervin Bano** | **Z. Sajmir Dautaj** |

**STATUT**
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**
**"ANES" Sh.p.k.**

Sot më datë 08.01.2024, palët e mëposhtme:

- **Z. Artur Asllani**, qytetar shqiptar, lindur më 12.08.1973, në Tiranë, Shqipëri, banues në Rruga "Medar Shtylla", Pall. Tirhino, Kulla D, Ap. 16, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit shqiptar me nr. 038730133 dhe numer personal H30812127J;
- **Z. Neritan Kallfa**, qytetar shqiptar, lindur më 23.03.1969, në Tiranë, Shqipëri, banues në Rruga "Ibrahim Shalqizi", Mjull Bathore, Farke Sauk, Rezidenca "Touch of the Sun", Godina B4, Ap. 404, Kodi Postar 1044, Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit shqiptar me nr. 033708601 dhe numer personal G90323173Q;
- **Z. Ervin Bano**, qytetar shqiptar, lindur më 21.07.1977, në Vlorë, Shqipëri, banues në Rruga "Ndreke Luca", Ndertesa 10, Hyrja 3, Ap. 17, Kodi Postar 1019, Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit shqiptar me nr. 036027418 dhe numer personal H70721130E; dhe
- **Z. Sajmir Dautaj**, qytetar shqiptar, lindur më 25.08.1976, në Tiranë, Shqipëri, banues në Rruga "Sytki Çiço", Pall. 2, Shk. 1, Ap. 1, Kodi Postar 1008, Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit shqiptar me nr. 033611182 dhe numer personal H60825117I;

kanë vendosur të nënshkruajnë Statutin e mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe nga ky Statut.

## KAPITULLI I
## FORMA, EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA

### Neni 1 – Forma

1.1 Shoqëria "ANES" Sh.p.k. (në vijim "**Shoqëria**") krijohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij Statuti dhe Aktit të Themelimit.

1.2 Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

1.3 Akti i Themelimit dhe Statuti janë në përputhje me legjislacionin shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në to, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

### Neni 2 – Emërtimi

2.1 Emërtimi i Shoqërisë është "ANES" Sh.p.k.

### Neni 3 – Objekti i shoqërisë

3.1 Shoqëria ka për objekt kryerjen e aktiviteteve tregtare në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

3.2 Në mënyrë më specifike, Shoqëria ka për objekt kryerjen e shërbimeve profesionale të këshillimit në favor çdo individi, personi fizik dhe personi juridik si vijon:

(a) Këshillim dhe asistencë në çështje të administrimit dhe të organizimit, të nevojshme për funksionimin e aktivitetit të klientëve;

(b) Përditësim dhe organizim kontabiliteti, konsulencë kontabiliteti, fiskale, financiare, tatimore si edhe përgatitje pasqyrash financiare;
(c) Asistencë në aplikimin dhe nxjerrjen e lejeve, liçensave, autorizimeve të nevojshme për kryerjen e aktivitetit të klientëve;
(d) Këshillim lidhur me analiza teknike e profesionale për vlerësimin e lejeve, liçensave, autorizimeve, konçesioneve, akteve administrative apo kontratave dhe operacioneve tregtare dhe jo-tregtare që lidhen me klientët;
(e) Këshillim në fushën e organizimit, funksionimit, ndarjes së përgjegjësive të shoqërive tregtare dhe/ose organizatave joftimiprurese;
(f) Këshillim në fushën e punësimit;
(g) Realizimin e studimeve te fizibilitetit dhe të planeve të biznesit;
(h) Veprimtari komisionere, ndërmjetësime, përfaqësime në transaksione tregtare si edhe në secilën prej fushave të objektit të shoqërisë sipas këtij neni;
(i) Asistencë dhe këshillim në operacione që lidhen me krijimin, shndërrimin, transformimin, prishjen, likujdimin apo falimentimin e shoqërive tregtare dhe të organizatave jofitimprurëse;
(j) Këshillim dhe asistencë lidhur me pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, përfshirë edhe asistencë dhe hartim raporte të vlerësimit;
(k) Këshillim dhe asistencë lidhur me çështje mjedisore, përfshirë edhe asistencë dhe hartim raporte të vlerësimit;
(l) Çdo këshillim, asistencë dhe shërbim tjetër që lidhet me administrimin apo çështjet e biznesit e në fusha të ngjashme me to.

3.3 Shoqëria mund të kryejë çdo operacion tregtar, operacione që lidhen me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, operacione financiare dhe kredimarrje, të japë garanci të tretëve si edhe të blejë dhe shesë ose marrë me qira ndërmarrje, degë ndërmarrjesh, si edhe të ketë pjesëmarrje në shoqëri, ente, konsociume, që kanë objekt të njëjtë ose të ngjashëm me të vetin apo gjithsesi funksional për arritjen e qëllimeve të shoqërisë. Më në përgjithësi, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të shoqërisë.

3.4 Me qëllim përmbushjen e secilit prej aktiviteteve që përbëjnë objektin e saj, Shoqëria mund të kontraktojë apo angazhojë çdo person, qoftë individ apo subjekt juridik.

## Neni 4 – Selia

4.1 Selia e Shoqërisë është në Rruga "Abdi Toptani", Torre Drin, Kati 2, zyra 21/1, Tiranë, Shqipëri.

4.2 Transferimi i selisë së Shoqërisë në një vend tjetër bëhet me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme.

4.3 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë.

## Neni 5 – Kohëzgjatja e veprimtarisë

5.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar.

5.2 Shoqëria mund të prishet përpara këtij afati ose mund të zgjasë kohëzgjatjen e saj me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të nevojshëm për ndryshimin e statutit.

## KAPITULLI II
## KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE

### Neni 6 – Kapitali themeltar

6.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është ALL 100,000 (njëqindmijë Lekë).

6.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 4 (katër) kuota, të gjitha të nënshkruara dhe të shlyera nga ortakët.

### Neni 7 - Kontributet

7.1 Kontributi në kapitalin e Shoqërisë është ofruar si më poshtë:

- **Z. Artur Asllani**, qytetar shqiptar, lindur më 12.08.1973, në Tiranë, Shqipëri, banues në Rruga "Medar Shtylla", Pall. Tirhino, Kulla D, Ap. 16, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit shqiptar me nr. 038730133 dhe numer personal H30812127J ka ofruar një kontribut në para të barabartë me ALL 25,000 (njëzetepesëmijë Lekë), në favor të shoqërisë në themelim e sipër;
- **Z. Neritan Kallfa**, qytetar shqiptar, lindur më 23.03.1969, në Tiranë, Shqipëri, banues në Rruga "Ibrahim Shalqizi", Mjull Bathore, Farke Sauk, Rezidenca "Touch of the Sun", Godina B4, Ap. 404, Kodi Postar 1044, Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit shqiptar me nr. 033708601 dhe numer personal G90323173Q ka ofruar një kontribut në para të barabartë me ALL 25,000 (njëzetepesëmijë Lekë), në favor të shoqërisë në themelim e sipër;
- **Z. Ervin Bano**, qytetar shqiptar, lindur më 21.07.1977, në Vlorë, Shqipëri, banues në Rruga "Ndreke Luca", Ndertesa 10, Hyrja 3, Ap. 17, Kodi Postar 1019, Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit shqiptar me nr. 036027418 dhe numer personal H70721130E ka ofruar një kontribut në para të barabartë me ALL 25,000 (njëzetepesëmijë Lekë), në favor të shoqërisë në themelim e sipër; dhe
- **Z. Sajmir Dautaj**, qytetar shqiptar, lindur më 25.08.1976, në Tiranë, Shqipëri, banues në Rruga "Sytki Çiço", Pall. 2, Shk. 1, Ap. 1, Kodi Postar 1008, Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit shqiptar me nr. 033611182 dhe numer personal H60825117I ka ofruar një kontribut në para të barabartë me ALL 25,000 (njëzetepesëmijë Lekë), në favor të shoqërisë në themelim e sipër.

7.2 Sipas kontributeve të mësipërme:

- **Z. Artur Asllani**, qytetar shqiptar, lindur më 12.08.1973, në Tiranë, Shqipëri, banues në Rruga "Medar Shtylla", Pall. Tirhino, Kulla D, Ap. 16, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit shqiptar me nr. 038730133 dhe numer personal H30812127J i përket 1 (një) kuotë, që i korrespondon 25% (njëzetëepesëpërqind) të kapitalit të Shoqërisë;
- **Z. Neritan Kallfa**, qytetar shqiptar, lindur më 23.03.1969, në Tiranë, Shqipëri, banues në Rruga "Ibrahim Shalqizi", Mjull Bathore, Farke Sauk, Rezidenca "Touch of the Sun", Godina B4, Ap. 404, Kodi Postar 1044, Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit shqiptar me nr. 033708601 dhe numer personal G90323173Q i përket 1 (një) kuotë, që i korrespondon 25% (njëzetëepesëpërqind) të kapitalit të Shoqërisë;
- **Z. Ervin Bano**, qytetar shqiptar, lindur më 21.07.1977, në Vlorë, Shqipëri, banues në Rruga "Ndreke Luca", Ndertesa 10, Hyrja 3, Ap. 17, Kodi Postar 1019, Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit shqiptar me nr. 036027418 dhe numer personal H70721130E i përket 1 (një) kuotë, që i korrespondon 25% (njëzetëepesëpërqind) të kapitalit të Shoqërisë; dhe
- **Z. Sajmir Dautaj**, qytetar shqiptar, lindur më 25.08.1976, në Tiranë, Shqipëri, banues në Rruga "Sytki Çiço", Pall. 2, Shk. 1, Ap. 1, Kodi Postar 1008, Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit shqiptar me nr. 033611182 dhe numer personal

A NK

H60825117I i përket 1 (një) kuotë, që i korrespondon 25% (njëzetëepesëpërqind) të kapitalit të Shoqërisë.

**Neni 8 – Rritja e kapitalit themeltar**

8.1 Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme me shumicën që është e nevojshme për ndryshimin e Statutit.

8.2 Në rast rritjeje të kapitalit, të gjithë ortakët kanë të drejtën të nënshkruajnë rritjen në raport me pjesët e kapitalit të zotëruara. Në rast se disa nga ortakët nuk e ushtrojnë këtë të drejtë, pjesët e tyre mund të nënshkruhen nga ortakët e tjerë proporcionalisht me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre.

**Neni 9 – Zvogëlimi i kapitalit themeltar**

9.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme me shumicën që është e nevojshme për ndryshimin e Statutit. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.

9.2 Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve në të njëjtën masë me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre.

**Neni 10 – Transferimi i kuotave**

10.1 Kuotat janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

10.2 Në rast transferimi në çdo lloj forme, si me shpërblim ashtu edhe pa shpërblim në kuptimin më të gjerë të fjalës, duke përfshirë këtu edhe dhurimin në favor të personave të tjerë të ndryshëm nga ortakët, kuotat duhet më parë t'i ofrohen në parablerje ortakëve të tjerë, përvec rasteve të transferimit në çdo lloj forme në favor të fëmijëve dhe/ose bashkëshortit të ortakut ose për shkak trashëgimie *mortis causa* në favor të trashëgimtarëve.

10.3 Në një rast të tillë ortaku që do të transferojë kuotat e tij të kapitalit duhet t'i njoftojë ortakët e tjerë, me letër rekomande me kthim përgjigje (në vijim "**Njoftimi**"), (a) numrin e kuotave të ofruara; (b) emrin e blerësit/përfituesit; (c) çmimin e rënë dakort për çdo kuotë, i përcaktuar në çdo rast në para, ose në vlerën në para në rast të një kundërshpërblimi tjetër të mundshëm (në rast shkëmbimi, kompensimi vullnetar, transaksioni, dhe çdo rast tjetër transferimi me shpërblim), ose vlerën e objektit të transferimit në rastin e transferimit pa shpërblim; (d) modalitetet e pagesës; (e) ftesën për të ushtruar të drejtën e parablerjes. E drejta e parablerjes i referohet të gjitha kuotave të kapitalit ofruar për shitje.

10.4 Ortakët do të kenë në dispozicion 30 (tridhjetë) ditë nga marrja e Njoftimit, për t'i komunikuar ortakut që transferon kuotën, synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, prezumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.

10.5 Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë, kuota e ofruara nga ortaku që transferon kuotën, do të ndahet nga ortakët pranues, në të njëjtën masë me kuotën që ata zotërojnë, përveç rastit kur ka një marrëveshje të kundërt. Në asnjë rast, pranuesi i ofertës nuk mund të ushtrojë pjesërisht të drejtën e parablerjes.

10.6 Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, kuota e ofruar në Njoftim mund t'i transferohet të tretëve sipas çmimit të specifikuar në të.

## KAPITULLI III
## ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME, ADMINISTRATORËT DHE EKSPERTI KONTABËL

### Neni 11 – Asambleja e Përgjithshme dhe kompetencat e saj

11.1 Organi vendim-marrës i Shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme.

11.2 Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështjet vijuese: ndryshimet e satutit, emërimi e shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabël e likuidatorëve, zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit, transferimi i kuotave, shpërndarja e fitimeve, riorganizimi dhe prishja e shoqërisë, miratimi i bilancit dhe për çdo vendim tjetër parashikuar nga ky Statut apo nga legjislacioni përkates.

### Neni 12 – E drejta e pjesëmarrjes dhe e votës

12.1 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamblenë e Përgjithshme, të paraqesë mendimin e tij dhe të japë aq vota sa është numri i kuotës që ai zotëron në kapitalin themeltar.

12.2 Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër jo-ortak, i pajisur me prokurë me shkrim, me anën e së cilës mund të japë votën e tij.

12.3 Ortaku nuk mund të lëshojë prokurë për votim për një pjesë të kapitalit që zotëron.

### Neni 13 – Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme, Kuorumi dhe Vendimet

13.1 Asambleja e Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e bilancit, të raportit të Administratorit, ekspertit kontabël si edhe inventarit.

13.2 Asambleja mund të thirret në çdo moment nga Administratori me iniciativën e tij ose sipas kërkeses me shkrim që do i drejtohet Administratorit nga një ose disa prej ortakëve që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të kapitalit themeltar. Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet njoftimit me letër rekomande me kthim përgjigje ose email, që duhet t'u dërgohet ortakëve të paktën 7 (shtatë) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme. Thirrja duhet të përmbajë informacion mbi llojin e Asamblesë së Përgjithshme, mbi çështjet që do të trajtohen dhe për të cilat do të merret vendim, mbi vendin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë.

13.3 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë.

13.4 Në rast se Asambleja e Përgjithshme nuk mblidhet me thirjen e parë për mungesën e kuorumit të parashikuar në nenin 13.7 apo 13.8 te këtij Statuti, Asambleja e Përgjithshme do të thirret brenda 7 (shtatë) ditësh me të njëjtin rend dite.

13.5 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahen edhe nëpërmjet telekonferencës dhe videokonferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe t'u lejohet atyre të ndjekin diskutimin dhe të ndërhyjnë në momentin e trajtimit të çeshtjeve në rend të ditës; pasi të jenë verifikuar këto kërkesa që duhet të rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja e Përgjithshme konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari në të cilin duhet të ndodhet edhe Sekretari i mbledhjes.

13.6 Asambleja e Përgjithshme do të thirret dhe mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit, në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të tërë

kapitalin themeltar.

13.7 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme për të cilat kërkohet një shumicë e thjeshtë, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zotërojnë të paktën 51% (pesëdhjetë e një përqind) të kapitalit themeltar. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme që kërkojnë një shumicë të cilësuar janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zotërojnë të paktën 76% (shtatëdhjetë e gjashtë përqind) të kapitalit themeltar.

13.8 Asambleja e Përgjithshme vendos ndryshimet e satutit, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit, transferimin e kuotave, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, me votën pro të ¾ (tre të katërtat) e ortakëve te pranishëm që zotërojnë të paktën 76% (shtatëdhjetë e gjashtë përqind) të kapitalit themeltar. Në të gjitha rastet e tjera, Asambleja e Përgjithshme merr vendime me shumicë të thjeshtë votash të ortakëve që zotërojnë të paktën 51% (pesëdhjetë e një përqind) të kapitalit themeltar.

13.9 Çdo mbledhje e Asamblesë së Përgjithshme drejtohet nga një ortak ose ndonjë përson tjetër i caktuar nga vetë Asambleja e Përgjithshme. Për pasqyrimin e vendimit Asambleja e Përgjithshme emëron një Sekretar, që mund të jetë edhe jo-ortak.

13.10 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të nënshkruhen nga Kryetari i Asamblesë dhe nga Sekretari.

**Neni 14 – Administrimi**

14.1 Shoqëria administrohet nga të paktën 1 (një) Administrator, i cili emërohet për një periudhë deri në 5 (pesë) vite. Administratori mund të rizgjidhet në detyrë.

14.2 Përfaqësimi ligjor i Shoqërisë i besohet Administratorit. Administratori mund të ushtrojë të gjitha kompetencat në përputhje me sa parashikohet në nenin 95 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*" dhe në çdo rast duke respektuar kufizimet e përcaktuara në aktin e emërimit dhe/ose nga ky Statut.

14.3 Administratori mund të emërojë përfaqësues të posaçëm për veprime apo kategori të caktuara veprimesh.

**Neni 15 – Eksperti kontabël i autorizuar**

15.1 Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Përgjithshme, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë mund t'i besohet një ose disa ekspertëve kontabël të autorizuar.

15.2 Eksperti kontabël i autorizuar mund të emërohet dhe shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

## KAPITULLI IV
## VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE

**Neni 16 - Viti financiar dhe bilanci vjetor**

16.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit.

16.2 Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe përfundon më 31 dhjetor të të njëjtit vit.

16.3 Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe ekspertit kontabël të

autorizuar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kërkuar sipas nenit 13.8 të këtij Statuti.

16.4 Miratimi i dokumentave që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve që nga fundi i vitit financiar.

**Neni 17 – Fitimet**

17.1 Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, u shpërndahen ortakëve në proporcion me kuotën e zotëruar.

17.2 Asambleja mund të vendosë destinimin e fitimeve në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo dhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.

## KAPITULLI V
## SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

**Neni 18 – Prishja**

18.1 Shoqëria prishet me përfundimin e afatit të parashikuar nga Statuti, ose përpara përfundimit në rastet e parashikuara nga ligji, ose me anë të një vendimi të Asamblesë së Përgjithshme, me shumicën e kërkuar për ndryshimet në statut.

18.2 Shoqëria nuk prishet në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar, vdekjes, ose falimentimit të ortakëve.

**Neni 19 – Likuidimi**

19.1 Në rast prishje, Shoqëria duhet të likuidohet.

19.2 Për të administruar këtë proçedurë, Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin një bilanc mbi gjendjen e shoqërisë në çastin e hapjes së procedurës së likuidimit.

19.3 Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja e Përgjithshme vendos mbi bilancin financiar përfundimtarmbi punën e kryer nga likuidatori dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.

19.4 Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kerkesave per arketim, likuidatori do t'i shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit ortakëve, në proporcion me kuotat e zotëruara prej tyre në kapitalin themeltar.

**Neni 20 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

20.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti dhe aktit të themelimit, si edhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve (përveç atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.

20.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ato do t'i besohen Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

## Neni 21 – Gjuha

21.1 Ky Statut është hartuar në 6 (gjashtë) kopje në gjuhën shqipe.

* * *

ORTAKËT

Z. Artur Asllani

Z. Neritan Kallfa

Z. Ervin Bano

Z. Sajmir Dautaj

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**
**DEGA VENDORE TIRANË**
**NOTER VALBONA SH. SELIMI**

V20240527300052409 29

**DATE 08/01/2024**
**NR REP 98**

## VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 08.01.2024 para meje Notere VALBONA SH. SELIMI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, ne zyrën në adresën Tirane, Rr.'Hoxha Tahsim', Godina nr.292, Kati i I-re, Tirane, u paraqiten personalisht:

**NËNSHKRUES**: **Artur Asllani**, atësia Bashkim, amësia Sheqere, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Zh.Dark; Njësia Administrative Nr. 2; 0000; Tiranë, lindur më 12/08/1973, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 038730133 dhe nr. personal H30812127J .

**NËNSHKRUES**: **Neritan Kallfa**, atësia Ismail, amësia Adile, shtetas Shqiptar, lindur në Tirane dhe banues në TIRANË, me adresë Gjikë Kuqali; Nd. 14; H. 1; Ap. 30; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 23/03/1969, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033708601 dhe nr. personal G90323173Q.

**NËNSHKRUES**: **Ervin Bano**, atësia Harallamb, amësia Enriketa, shtetas Shqiptar, lindur në Vlorë dhe banues në Tiranë, me adresë Ndreke Luca; Nd. Nd.10; H. 3; Ap. 17; Njësia Administrative Nr. 5; Njesia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 21/07/1977, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036027418 dhe nr. personal H70721130E.

**NËNSHKRUES**: **Sajmir Dautaj**, atësia Saliko, amësia Bajame, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Blv. Zhanë D'ark; Nd. 125; H. 1; Ap. 22; Njësia Administrative Nr. 3; Njësia Bashkiake Nr. 3; 1005; Tiranë, lindur më 25/08/1976, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033611182 dhe nr. personal H60825117I.

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje noteres, "Statutin dhe aktin e themelimit te shoqerise "ANES" shpk , bashkëlidhur ketij vertetimi noterial.

Unë Noterja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 *"Për Noterinë"*, dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005, vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTERE**

VALBONA SH. SELIMI

PULLE TARIFE 200 LEKE R.SHQIPERISE